



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **pestë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **26.09.2016**, dhe do të fillojë në orën **15:00** .

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës. Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019;
3. Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme;
4. Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave;
5. Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizik;
8. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin përfundimtar për kërkesën e grupit të qytetarëve të lagjes "Prishtina e Re - Zona Perëndim;
9. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01 nr.031-52761 dt.04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F-F" ndërmjet blloqeve "B1" dhe "B2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit 07 nr.463-651/98 dt.19.09.1998, të Komisionit për kthimin e tokës së Kuvendit të Qytetit të Prishtinës;
11. Raportimi i komisioneve te aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale;
12. Të ndryshme.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.nr.006-236-976 ,më 20.09.2016**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*